



**STATUTI**

**SEGMENT SHA**

## KAPITULLI I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 1

#### *Emri dhe forma e Shoqerise*

- (1) Nëpërmjet këtij akti rregullohet funksionimi i shoqerise aksionare Segment sha, e cila eshte nje shoqeri qe rezulton si pasoje e shnderrimit te formes ligjore te shoqerise ekzistuese Segment shpk, nje shoqërie me përgjegjësi të kufizuar qe shnderrohet ne nje shoqëri aksionare.
- (2) Shoqeria qe rezulton nga shnderrimi do te jete nje shoqëri aksionare me ofertë private me emërtimin Segment sha, në vijim Shoqëria.
- (3) Shoqëria është person juridik shqiptar sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- (4) Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë statut.

### Neni 2

#### *Selia e Shoqerise*

- (1) Selia e Shoqërisë është në adresën:  
Autostrada Tirane Durres, km 7, Kashar  
Tiranë, Shqipëri.
- (2) Administratorët vendosin për të hapur degë apo zyra përfaqesimi brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë tij.

### Neni 3

#### *Kohëzgjatja e Shoqerise*

- (1) Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit është i pakufizuar. Aksioneret e Shoqërisë mund te vendosin kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa here, me vendim te Asamblese se Aksionareve.

### Neni 4

#### *Objekti i veprimtarisë*

- (1) Objekti i Veprimtarise së Shoqërisë është por duke mos u kufizuar:

➤ **Në fushën e tregtisë dhe të karakterit të përgjithshëm:**

- Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice te makinerive dhe pajisjeve qe perdoren per guroret dhe minierat, per fushen inxhinierike e mekanike, sonda dhe pajisje te cdo lloj per punimet shpimeve e kerkimeve gjeodezike e gjeologjike, per punimet topografike e sizmike, te fizibilitetit te tokes etj, per punimet e ndertimit, per ndermarrjet industriale, veprave te ndryshme teknike apo te infrastruktures si dhe tregtimit me shumice dhe pakice import-eksport te pjeseve te kembimit te cdo tipi per keto makineri apo cdo lloj



materiali tjetër që përdoret për gurorët dhe minierat si dhe në fushat përkatëse të specifikuar më sipër.

- Montimi dhe instalimi, riparimi dhe mirëmbajtja e makinerive të betonit, asfaltit, të gurorëve dhe minierave, të ndertimeve etj. si dhe kryerja e shërbimeve të ndryshme inxhinieriko-mekanike të çdo lloji që përdoren në aktivitetet përkatëse të përcaktuara në piken e mesipërme të këtij objekti.
- Prodhimi i makinerive e pajisjeve për gurorët dhe minierat dhe në përgjithësi për çdo lloj makinerie që përdoret në fushën e gurorëve dhe minierave apo dhe në fushën e ndertimit, shpimeve gjeodezike etj, import-eksport i tyre, tregtim i tyre brenda vendit si dhe shitje për eksport jashtë vendit.
- Për realizimin e shitjeve të makinerive të gurorëve dhe minierave si dhe të pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit të këtyre makinerive, shoqëria mund të kryej rolin e komisionerit apo të ndermjetësit tregtar, të hap zyra përfaqësimi si brenda vendit ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Tregtimin me shumicë dhe pakicë import-eksport të çdo lloji malli industriale dhe ushqimore, lende të para, pjesë këmbimi etj.
- Dhenie me qera personave të tretë, personave fizike ose personave juridike të objekteve të lira, makinerive dhe pajisjeve dhe ambienteve të ndryshme si magazina, zyra, që janë prone e shoqërisë.
- Hapje linjash të ndryshme prodhimi, etiketim, ambalazhim, numerim, peshim mallrash konfeksioni dhe tekstili, industriale, ushqimore etj.
- Shoqëria mund të ushtroje gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.
- Servisimi i makinerive, për të cilat mbulojmë distribucione me kontratë, lyerje me boje, modifikime në konstrukcion të makinerive dhe pajisjeve sipas kualifikimeve e licencave, trajnimve në vend dhe ato nderkombetare

➤ **Në fushën e ndertimeve, në zbatim përfshin aktivitetet si më poshtë:**

- Ndertime dhe rikonstrukcione për godina banimi, pallate të ndryshme, ndertime civile dhe ekonomike përfarëdo lloji objekti, veshje fasadash të godinave të ndryshme, prodhim e tregtim materiale inertesh e materiale të ndryshme ndertimi si dhe lende drusore etj.
- Ndertime rrugë kategoria e katërt, ndertim rrugë kategoria V, VI, ndertim rrugë kategoria III, II, I dhe rrugë speciale (autostrada etj), veshje asfalto betoni të rrugëve (ndertim mbishtrëse si dhe asfaltime e sistemime sheshe).
- Ndertime ujësjellëse dhe kanalizime.

➤ **Në fushën e tregtisë së karburanteve dhe lubrifikanteve:**

- Vajra industriale të çilesisë së lartë për makineri të renda, kompresore, gjeneratorë, kamiona dhe makineri specifike të prodhimit, kryesisht në fushën e seksionit të ndertimit dhe prodhimit. Tregtim, shitje blerje, import dhe eksport i vajrave, graso, additive dhe nënprodukte të tyre

(2) Në përmbushjen e qëllimeve të aktivitetit të saj, shoqëria mund të lidhë kontrata bashkëpunimi dhe marrëveshje të tjera me kompani të tjera vendase dhe të huaja.

## KAPITULLI II KAPITALI DHE AKSIONET

### Neni 5

#### *Kapitali ligjor - Aksionet*

- (1) Kapitali aksionar i shoqërisë është 10.000.000 leke.
- (2) Kapitali aksionar i shoqërisë është ndarë në 100 aksione të zakonshme me një vlerë nominale 100.000 leke secila. Aksionet janë të pandashëm.
- (3) Cdo aksion i zakonshëm i jep zoteruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.
- (4) Ndalohet emetimi i akcioneve, të cilat i japin zoteruesit të tyre me shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit që aksioni përfaqëson.
- (5) Aksionaret shlyejnë vlerën nominale të aksionit në llogarinë e shoqërisë siç parashikohet në kete Statut.

### Neni 6

#### *Mbi zotërimin e Kuotave*

- (1) Aksioneri Ajten Goci zoteron 40 përqind të aksioneve ose 40 copë, ekuivalente me 4.000.000 lekë.
- (2) Aksioneri Ermir Goci zoteron 30 përqind të aksioneve ose 30 copë, ekuivalente me 3.000.000 lekë.
- (3) Aksioneri Marco Baiardo zoteron 30 përqind të aksioneve ose 30 copë, ekuivalente me 3.000.000 lekë.
- (4) Aksionari mund të transferojë aksionet në përputhje me ligjin dhe parashikimet në këtë statut.

### Neni 7

#### *Mbi të drejtat e aksionarëve*

- (1) Aksionarët ekzistues kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve.
- (2) Aksionarët kanë të drejtën e informimit mbi aktivitetin e Shoqërisë.

### Neni 8

#### *Rezerva ligjore, rezervat e tjera dhe dividendet*

- (1) Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 10 përqind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 përqind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë nëse vendoset me vendim të Asamblesë së Aksionereve.
- (2) Shoqëria mund të parashikojë krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.
- (3) Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij Neni.

### KAPITULLI III ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

#### Neni 9

##### *Asambleja e aksionarëve*

- (1) Asambleja e aksionarëve merr vendim në përputhje me ligjin dhe parashikimet në këtë statut.
- (2) Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
  - (a) përcaktimin e politikave tregtare;
  - (b) ndryshime të statutit;
  - (c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit;
  - (d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - (e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "d" të kësaj pike;
  - (f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - (g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - (h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - (i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
  - (j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
  - (k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - (l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
  - (m) blerja e pasurive të paluajtshme;
  - (n) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, likuidatorëve apo ekspertëve kontabël të pavarur;
- (3) Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

#### Neni 10

##### *Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme*

- (1) Asambleja e përgjithshme mbledhet dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, por jo me pak se një herë në vit.
- (2) Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe në rastet e parashikuara nga ligji, nga anëtarët e këshillit të administrimit.
- (3) Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
- (4) Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të audituara.
- (5) Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të



lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- (6) Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij Neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga audituesit ligjorë.

#### **Neni 11**


##### *Mënyra e thirrjes*

- (1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, te pakten 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- (2) Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:
- (a) Emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
  - (b) Një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble, e cila duhet të përfshijë:
    - i. të drejtat e aksionarëve;
    - ii. procedurat e votimit me prokurë, formularë të posaçëm, për t'u përdorur gjatë votimit me prokurë dhe mjetet elektronike, me të cilat shoqëria do të pranojë njoftimin e përfaqësuesve të autorizuar;
    - iii. procedurat për votimin, me mjete elektronike apo me korrespondencë;
  - (c) Informacion për vendin e mënyrat për të marrë në formë të plotë dokumentet dhe projektvendimet e përcaktuara;
  - (d) Adresën e faqes së internetit të shoqërisë, ku mund të merret informacioni i përcaktuar në këtë nen. Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, së bashku me rendin e ditës, vendosen edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

#### **Neni 12**

##### *Rendi i ditës*

- (1) Rendi i ditës, që njoftohet sipas Nenit me sipër, duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.
- (2) Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.
- (3) Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga aksionarët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.
- (4) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të kerkuara, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



### **Neni 13**

#### *Pjesëmarrja në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme*

- (1) Asambleja e përgjithshme cakton si kryetar të asamblese, Kryetarin (ose zëvendeskryetarin) e Keshillit Administrues dhe si sekretar të saj, sekretarin (ose zëvendessekretarin) e Keshillit Administrues.
- (2) Gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës. Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre. Përfaqësuesit duhet të jenë të pajisur me prokurë për përfaqësim.

### **Neni 14**

#### *Procesverbalet e mbledhjeve të asamblesë*

- (1) Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
- (2) Procesverbalit duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimarrjen, si dhe të aksionarëve, që janë shprehur kundër.
- (3) Procesverbalit i bashkëlidhen edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- (4) Procesverbalit dhe lista e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

### **Neni 15**

#### *Kuorumi*

- (1) Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve ligjore.
- (2) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij Neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



**Neni 16**  
*Marrja e vendimeve*

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, në lidhje me:
  - (a) ndryshimin e statutit,
  - (b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
  - (c) shpërndarjen e fitimeve,
  - (d) riorganizimin e shoqërisë,
  - (e) prishjen e shoqërisë.
- (2) Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.
- (3) Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

**Neni 17**  
*Mënyra e votimit*

- (1) Asambleja e përgjithshme merr vendimet, nëpërmjet votimit të hapur.
- (2) Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

**Neni 18**  
*Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi*

- (1) Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e vendimeve të administratorëve e, sipas rastiit, të këshillit të administrimit kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit.
- (2) Aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Aksionarët apo kreditorët e shoqërisë, të përcaktuar me sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës përkatëse për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e aksionarëve apo e kreditorëve vlerësohet e refuzuar.





**KAPITULLI IV**  
**KËSHILLI I ADMINISTRIMIT (SISTEMI ME NJË NIVEL)**

**Neni 19**


*Këshilli i administrimit*

- (1) Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
- (a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - (b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
  - (c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
  - (d) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
  - (e) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
  - (f) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
  - (g) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'u paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
  - (h) të sigurojë se auditimi i pasqyrave financiare të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "g" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
  - (i) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
  - (j) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
  - (k) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
  - (l) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja.

**Neni 20**

*Numri, emërimi dhe përbërja e këshillit të administrimit*

- (1) Këshilli i administrimit do të përbëhet nga tre anëtarë. Anëtarët janë individë, dhe shumica e tyre të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.
- (2) Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e votave të aksionereve që marrin pjesë dhe për një afat tre vjeçar. Anëtarët e këshillit të administrimit mund të rizgjidhen.



- (3) Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit me një afat **3 vjeçar** do të jenë:
- **Ajten Goci;**
  - **Leonard Sulkaj;**
  - **Bedri Zaçaj.**

#### **Neni 21**

##### *Zgjedhshmëria e kufizuar*

- (1) Anëtarët e këshillit të administrimit mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si edhe nga radhët e individëve të tjerë, jashtë shoqërisë.
- (2) Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i këshillit të administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është:
- (a) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikëqyrës në 2 shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
  - (b) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;
  - (c) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë së parë.
- (3) Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me pikën 2 të këtij Neni, është absolutisht i pavlefshëm.
- (4) Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit të administrimit detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

#### **Neni 22**

##### *Shkarkimi*

- (1) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- (2) Anëtar i këshillit të administrimit mund të shkarkohet me vendim të aksionarëve të pakicës, që e ka zgjedhur. Kur kushtet e parashikuara në statut për këtë emërim të veçantë nuk janë më në fuqi, asambleja e përgjithshme mund ta shkarkojë anëtarin në fjalë me shumicë të thjeshtë votash.
- (3) Këshilli i administrimit, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkelur detyrat e parashikuara për të nga ligji.

#### **KAPITULLI V**



## ADMINISTRATORËT

### Neni 23

#### Administratorët

- (1) Këshilli i administrimit emëron me shumicë të thjeshtë një ose disa persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat jo me te gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:
  - (a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
  - (b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare me pa kufizime;
  - (c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - (d) të përgatisin dhe të nënshkruajnë pasqyrat financiare, pasqyrat e konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
  - (e) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - (f) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
  - (g) të raportojnë përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
  - (h) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- (3) Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.
- (4) Administratorja e parë e Shoqërisë, për një periudhë **3 vjecare** emërohet:  
**Znj. Ajten Goci**
- (5) Kufizimet e kompetencave të administratorëve duhet të publikohen në regjistrin tregtar.

### Neni 24

#### Shpërblimi

- (1) Anëtarët e këshillit të administrimit mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e administratorëve mund të shtohet me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga këshilli i administrimit dhe miratohet nga asambleja e përgjithshme.

### Neni 25



*Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme*

- (2) Këshilli i administrimit mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e këshillit të administrimit për këto rregullore merren në mënyrë unanime.
- (3) Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht. Një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit të administrimit.
- (4) Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.
- (5) Këshilli i administrimit mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.

**Neni 26**

*Marrja e vendimeve*

- (1) Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.
- (2) Marrja e vendimeve kryhet nepermjet votimit me shkrim.

**Neni 27**

*Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia*

- (1) Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit detyrohen të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis.
- (2) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, kryejnë veprimet e mëposhtme:
  - (a) u kthejnë aksionarëve kontributet;
  - (b) u paguajnë aksionarëve interesa apo dividendë;
  - (c) nënshkruajnë, blejnë, pranojnë si garanci apo anulojnë aksionet e shoqërisë;
  - (d) emetojnë aksione përpara kalimit të kontributit në natyrë apo shlyerjes së vlerës nominale ose me çmim më të lartë;
  - (e) shpërndajnë aktivet e shoqërisë;

- (f) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të ishte parashikuar se shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese, për të shlyer detyrimet;
  - (g) në rast të zmadhimit të kapitalit, emetojnë aksione përpara përmbushjes së kushteve apo kur kontributi nuk është kaluar sipas kërkesave ligjore;
  - (h) kryejnë pagesa në favor të anëtarëve të këshillit të administrimit apo administratorëve;
  - (i) japin kredi.
- (3) Anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratorët përgjigjen në mënyrë solidare për vërtetësinë e të gjitha pasqyrave financiare, të publikimeve të detyrueshme dhe informacioneve të tjera kryesore të veprimtarisë së organizimit të shoqërisë, por pa u kufizuar në to.

## KAPITULLI VI PASQYRAT FINANCIARE DHE AUDITUESIT LIGJORË

### Neni 28

#### *Periudhat e raportimit*

- (1) Viti ekonomik fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti dhe Pasqyrat Financiare duhet të miratohen brenda gjashtë muajve që vijojnë.

### Neni 29

#### *Pasqyrat financiare dhe relacioni i organit ekzekutiv*

- (1) Në mbyllje të çdo viti ekonomik, organi administrativ, brenda tre muajve duhet të procedojë në përgatitjet e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të cilat përshkruajnë më së miri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen e kapitalit dhe flukset e parasë.
- (2) Pasqyrat Financiare duhet të shoqërohen nga një relacion i organit ekzekutiv që bën të qartë ecurinë e administrimit në sektorë të ndryshëm në të cilët Shoqëria ka vepruar, edhe me shoqëritë e tjera që kontrollohen prej saj, me një kujdes të veçantë si për investimet, për kostot dhe për çmimet ashtu edhe për faktet me rëndësi që janë vërtetuar pas mbylljes së veprimtarisë.

### Neni 30

#### *Audituesit ligjore*

- (1) Pasqyrat Financiare dhe relacioni i organit ekzekutiv duhet të jenë në dispozicion të audituesve ligjorë, të paktën 40 ditë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme që mblidhet për aprovimin e tyre.
- (2) Audituesit ligjorë auditojnë pasqyrat financiare. Audituesit duhet të emërohet nga asambleja e aksionarëve për një periudhë 1 vjeçare. Audituesit e parë të shoqërisë, për një periudhën 1 vjeçare emërohen z. Sokol Toska dhe znj. Ingegerta Bebi.

## KAPITULLI VII



## PRISHJA E SHOQËRISË

### Neni 31

*Shkaqet e prishjes së shoqërisë*

- (1) Shoqëria aksionare priset:
  - (a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
  - (b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
  - (c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - (d) me vendim gjykate.
- (2) Administratorët janë të detyruar të regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- (3) Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata regjistron vendimin e prishjes *ex officio*.

## KAPITULLI VIII

### DISPOZITA TË FUNDIT DHE LIGJI I ZBATUESHËM

### Neni 32

*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*

- (1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji shqiptar.

### Neni 33

*Dispozitat e fundit*

- (1) Për sa nuk është shprehur në statut do të zbatohet ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- (2) Ky Statut është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe pasi lexohet, e kuptohet nënshkruhet ligjërisht.

## AKSIONARËT

AJTEN GOCI

ERMIR GOCI

MARCO BAIARDO



18/05/2018